

Mbledhja e parë e kryesisë së shoqatës 17shkurti.ch për vitin 2019 e thirrur nga kryetari Ismet Abdyl

Data: 11.02.2018 Ora: 11:20, Vendi: Glattbrugg

Pjesmarrës: Qëndresa Sadriu, Ismet Abdyl, Rohan Foniqi, Bekim Haliti, Sevdail Xhelili, Musa Halili, Imran Asllani, Avni Kastrati

Mungon: askush

Protokoli:

Temat e ditës:

- Shkolla Futbollit
- Ekskursion per të moshurit në kuadër të 10 vjetorit të shoqatës
- Ndhma per skamnoret
- Ndhma per dy xhamit e fshatit
- Java kulturore
- Pingpong - Tischtennis
- Te ndryshme

1.Shkolla Futbollit (Organizator: Ruhani)

Shkolles së futbollit I nevojiten ndresa dhe topa të futbollit. Diskutohen idetë si si të ndihmohet shkolla e futbollit, të blihen mjetet sportive apo ti dërgohen të hollat, që ata vet ti blejnë. U vendos që të mblihet një pjesë të shumës në kryesi dhe aksioni të publikohet në facebook.

(Votimi: 7 anëtar janë për, asnjë kundër)

Shuma qe nevojitet eshte € 1000.-, kryesia vendos që në këte aksion të kerkohet shuma CHF 1200.-

Kryesia kontriboj menjëher me këte shumë: CHF 500.-

Qëndresa Sadriu 50.-

Ismeti Avdyli 100.-

Rohan Foniqi 50.-

Bekim Haliti 50.-

Sevdail Xhelili 50.-

Musa Halili 100.-

Imran Asllani 50.-

Avni Kastrati 50.-

Vlera ceket CHF 1200.-

2.Ekskursion per të moshurit në kuadër të 10 vjetorit të shoqatës

(Përgjegjës: Avniu)

Këtij projekti kryesia ja vendos emrin: Shetitje e lire per te moshuar

Vendoset qe shetitja do te jetë per gratë prej moshes 55 vjet, dhe per burra prej moshes 60 vjet.

Ideja është që te organizohet ne te njejten menyre si para 8 viteve dhe te realizohet ne muajin prill 2019. Gjithashtu do te behen dy shetitje, d.m.th. një për gratë dhe një për burra ndarasë.

Kush e organizon: Bujar Haziri, Ibrahim Foniqi, Xhemile Abdyl

(Votimi: 7 anëtar janë për, asnjë kundër)

3.Ndhma per skamnoret – familjet me nevojë

(Organizator: Avniu)

Mirret vendim që të ndihmohen 10 familje me nga CHF 50.- per familje d.m.th. CHF 500.

-Hagji Abdyl Megjidi, Arlind Abdyl do ti zgjedhin familjet.

Kryesia vendos qe ksaj here te japim ndihma ushqimore e jo financiare.

(Votimi: 7 anëtar janë për, asnjë kundër)

4.Ndihma per dy xhamit e fshatit
(Organizator: Avniu)

Propozimi eshte qe dy xhamive ti ndahen nga CHF 150.- në total = CHF 300.-
Fejzulla Kastrati kontribon me CHF 100.-

(Votimi: me shumic te votave kalon)

5.Java kulturore
(Organizator: Qëndresa)

⇒ Gara te leximit

Ideja eshte qe te bejm nje garë te leximit prej dates 4.3. - 31.7.2019 pjesëmarrës do të jenë nxënësit e klasëve 5. – 9. Do të shpërblehen tre fëmijët që lexojnë më së shumti libra gjatë kësaj kohe. Ky aksion duhet te behet ne bashkpunim me shkollën e fshatit.

Procedura e këtij aksioni eshte përgaditur nga Besit Abdylit si propozim, i cili mund të ndryshohet/plotësohet! Më poshtë mund ta lexoni propozimin:

Ideatori dhe sponsoruesi i garës

Zotëri Qamil Sadriu nga Gjilani I cili jeton në Zvicrër ka shprehur dëshirën që të organizohet një garë të leximit të librave letrarë dhe do ti shpërblej nxënësit qe lexojnë më shumë libra.

Organizimi dhe Bashkpunimi

Librat do të merren në bibliotekë ne fshatit ku nëpunësi i bibliotekës ka shprehur gatishmëri për bashkpunim duke i regjistruar librat të cilat nxënësit I marrin për ti lexuar nga fillimi i garës dhe e nxjerr rezultatin në përfundim të garës.

Gjithashtu nëpunësi i bibleotekës ofron bashkpunim për ti nxjerrë një listë më libratë nevojshëm që nuk gjenden në bibleotekë për të cilat sponsori ka shprehur gatishmëri për ti blerë dhe për tia dhuruar bibleotekës

Kush mund te marre pjese ne garë (Moshë/klaset)?

Në garë mund të marrin pjesë nxënësit nga klasa e V-të deri në klasën e IX-të.

Periudha kohore ku zhvillohet gara

Gara fillon më 04.03.2019 deri më 31.07.2019 (gjithësej katër muaj)

Përzgjedhja e fituesve

Përzgjedhja e fituesve do të bëhet duke marrë të dhënat nga biblioteka e fshatit se kush ka lexuar numër më të madh të librave

Librat që janë të obliguar nga lënda e gjuhës dhe letërsisë shqipe nuk duhet të anashkalohe

Librat duhet të jene e kuivalente me moshën por edhe për më të rritur, kurse si për moshë më të vogël.

Në mënyrë që garuesit mos ti lënë mësimët e lëndëve tjera anash, fitues nuk mund të jetë nxënësi që në gjysmë vjetorin e ka suksesin më të vogël së gjysmëvjetori paraprak

Për të gjitha librat e lexuar duhet të jëtë në gjendje ta bëjë një përshkrim.

Të formohet një komision prej tre anëtarëve (Mësimdhënës, nëpunësi i bibleotekës dhe nga këshilli i prindërve)

Shpërblimet

Shpërblimet do të jenë befasi nga sponsori deri në ditën e shpërndarjes!

Data dhe vendi i shpërndarjes së shpërblimeve

Shpërblimet do të shpërndahen me datë 04.08.2019 – Dita e dëshmorëve në Dobërcan) te objekti i bibleotekës së fshatit

Agroni dhe Qamili e shkruajn idenë sakt dhe Ismeti kontakton drejtorin e shkolles.

⇒ Te mbjedhet nje lis per perkujtim te Hoxhës Mulla Nusret Hajdarit (Investitor Familja Sadriu)

⇒ Në kuadër të turnirit të futbollit ndahet sikur viteve të kaluara një qmim per ekipin më Fair play (Investitor Familja Sadriu)

Sigurimi i mjeteve sportive (topa) do te behet nga Fam. Sadriu

⇒ Organizator: Familja Sadriu ne koordimin me shoqaten

(Votimi: 7 anëtar janë për, asnjë kundër)

6.Pingpong - Tischtennis
(Organizator: Ismeti)

Propozohet që të ndahet dikujt për detyrë që ta realizon këtë projekt në vendngjarje.

Ideja është që të realizojmë një apo dy pingponga në shkollë. Diskutohen dy propozime:

1. Një me rrota (aty kritikohet që nuk mundet të shfrytëzohet kur është shkolla e mbyllur)
2. Një te betonit apo me mermer

⇒ Vendoset që të kontaktojmë drejtorin e shkolles dhe në një hap të dytë të evaluojmë dhe njëherë se cilin propozim ta realizojmë

⇒ Ismeti kontakton drejtorin e shkolles

7. Te ndryshme

Investime për lula (Sevdaili)

Sevdaili propozon që të shqyrtohet projekti i lulëve :

Propozimi i tij është që me ble lule me jetë më gjatë që mos me investu çdo vjet.

Avnia dhe ismeti argumentojnë që mirëmbajtja e luleve të propozueme është më e komplikuar si që është për momentin. Për këtë arsye shumica e kryesisë vendosë që ta lëmi projektin si që është.